

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6339
E mërkurë, 16 qershor 2021
çmimi 0.40 €

Zgjedhjet lokale mbahen më 17 tetor

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ËSHTË MBAJTUR TAKIMI I PARË NË BRUKSEL NDËRMJET KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS, ALBIN KURTI DHE PRESIDENTIT TË SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ

FAQE 4-5

KOSOVA DHE SERBIA NUK PAJTOHEN PËR AGJENDËN E DIALOGUT



Takimi i parë ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka përfunduar pa ndonjë rezultat të martën në Bruksel. Udhëheqësit e të dy shteteve në këtë takim kanë prezantuar temat e tyre, duke mos u pajtuar për agjendën e dialogut të ardhshëm. Kryeministri Kurti ka thënë se në këtë takim ka prezantuar katër propozime të cilat nuk i janë marrë parasysh, ndërsa presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës. Takimi i radhës është paraparë të mbahet më 25 korrik

OPINION

VARRI I MEHMETRIZA MURTEZANIT, NË GJENDJE TË MJERUAR F. 6

Lulëzim ETEMAJ



AKTUALE



OBSH-ja: NUMRI I TË INFektUARVE ME COVID PO BIE, POR JO I TË VDEKURVE F. 2

VITIA: OBJEKTIVI YNË MBETET VAKSINIMI DERI NË 60 PËR QIND I QYTETARËVE F. 7

EKONOMI

FILLON EKZEKUTIMI I PAGESAVE TË SUBVENCIONEVE NË BUJQËSI F. 9

HAJDARI: JEMI DUKE PUNUAR PËR FORMIMIN E GJYKATËS KOMERCIALE F. 9

KULTURË

SHKODRAN DAKAJ DHE "ARMAGEDONI" I DHUROJNË LIBRA SHKOLLËS 'ESAD MEKULI' F. 10



DAKA: SHKARKIMI IM ËSHTË JOKUSHTETUES, DO T' I NDJEK RRUGËT LIGJORE

FAQE 3



NË GJASHTËMUJORIN E DYTË TË 2020-S JANË SEKUESTRUAR 649 ARMË

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBSh-ja: Numri i të infektuarve me Covid po bie, por jo i të vdekurve



GJENEVË, 15 QERSHOR - Numri i rasteve të reja me koronavirus ka rënë në shtatë javët e fundit, ka thënë shefi i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Tedros Adhanom Ghebreyesus, mirëpo ai ka njoftuar se numri i të vdekurve brenda ditës arrin në mbi 10 000.

Shefi i OBSh-së ka thënë më 14 qershor se rënia e numrit të rasteve në periudhë prej shtatë javësh është më e gjata prej kur ka

nisur pandemia. Mirëpo vdekjet, sipas tij, nuk po e ndjekin trendin e njëjtë për shkak të mungesës së qasjes në vaksina në disa shtete. "Virusi është duke u përhapur më shpejt sesa vaksinat", ka thënë Tedros në një konferencë për media më 14 qershor.

Tedros ka mirëpritur premtimet e liderëve të grupit të shtatë vendeve më të industrializuara (G7) për ndarje të 870 milionë vaksinave për COVAX, mirëpo ka

thënë se edhe 11 miliardë doza të tjera janë të nevojshme. COVAX është nismë e OBSh-së për ndarje të vaksinave në vendet e varfra.

Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", prej shpërthimit të koronavirusit në fund të vitit 2019, autoritetet në gjithë botën kanë regjistruar mbi 176 milionë persona të infektuar. Prej këtyre, mbi 3.8 milionë pacientë kanë vdekur.

Zaevi nuk shpreson në marrëveshje me Bullgarinë në qershor

SHKUP, 15 QERSHOR - Kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, nuk është optimist për një zgjidhje të mundshme të kontestit me Bullgarinë deri më 22 qershor, kur është paraparë mbajtja e samitit të ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Zgjidhja eventuale e dallimeve në mes të Shkupit dhe Sofjes nënkupton edhe zhblokimin e procesit integruar apo nisjen e bisedimeve të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian. "Kam ndjenjë se dallimet nuk do të

zgjidhen më 22 qershor, sepse Bullgaria ka një qeveri teknike dhe nuk ka Parlament. Por, nuk është e pamundur të zgjidhen. Pse po e them këtë? Realiteti është se në Bullgari ka zgjedhje më 11 korrik. Por, në të njëjtën kohë, unë kam një ndjenjë përgjegjësie përpara njerëzve tanë të them se është detyra jonë të bëjmë gjithçka. Nuk do të kishte asgjë të dëmshme nëse ne arrijmë të përfundojmë një marrëveshje që do të verifikohet nga qeveria e ardhshme politike dhe parlamenti bullgar", ka

deklaruar Zaev.

Kryeministri maqedonas disa herë më parë ka thënë se pret gjëra pozitive gjatë muajit qershor, duke shpresuar në kapërcimin e dallimeve me Bullgarinë.

Këto dallime kanë të bëjnë me gjuhën, identitetin dhe të kaluarën historike.

Bullgaria ka thënë se nuk e konteston identitetin maqedonas, por kërkon që Shkupi të pranojë se para periudhës së Luftës së Dytë Botërore, maqedonasit dhe gjuha e tyre kanë pasur "rrenjë bullgare".



Ikea në Francë gjobitet me 1 milion euro për spiunim të stafit



PARIS, 15 QERSHOR - Një gjykatë franceze urdhëroi gjigantin suedez të mobilieve "Ikea" të paguajë gjobë prej një milion eurosh, pasi u gjet fajtor për spiunim të stafit në Francë.

Ish-shefi i "Ikeas"-s në Francë, Jean-Louis Baillet, u dënua me dy vjet burgim me kusht dhe me gjobë prej 50 000 eurosh.

Dega në Francë e "Ikea"-s u zbulua se ka përdorur detektivë privatë dhe oficerë të policisë për të mbledhur të dhëna private për stafin.

Dëshmitë dolën në pah në vitin 2012. Për pasojë, "Ikea" shkarkoi katër menaxherë dhe miratoi kod të ri të sjelljes.

Pesëmbëdhjetë të akuzuarit që dolën në gjykatën e Versajës, përfshinin drejtues të lartë dhe ish-menaxherë të dyqaneve.

Katër oficerë të policisë ishin, po ashtu, në gjyq për dorëzimin e informacioneve konfidenciale.

Me nisjen e gjyqit, "Ikea" në Francë lëshoi një deklaratë, duke thënë se i "dënon fuqishëm" shkeljet e privatësisë dhe se kërkon falje për "këtë situatë që dëmton seriozisht vlerat e kompanisë dhe standardet etike".

Fatura vjetore e "Ikea"-s për hetuesit privatë shkoi deri në 600 000 euro, raportoi agjencia e lajmeve AFP, duke cituar dokumentet e gjykatës.

Britania e Madhe shtyn heqjen e plotë të kufizimeve

LONDËR, 15 QERSHOR - Britania e Madhe ka shtyrë heqjen përfundimtare të të gjitha kufizimeve kundër pandemisë deri më 19 korrik.

Kryeministri britanik, Boris Johnson, ka thënë se shtyrja

po ndodh për shkak të një rritjeje të numrit të të infektuarve me variantin Delta të koronavirusit.

Planet e qeverisë britanike kanë qenë që më 21 qershor të rihapet plotësisht ekonomia e vendit. Në

Angli, shumica e rregullave aktuale, përfshirë kufizimet në numrin e njerëzve që mund të takohen në bare dhe restorante, do të vazhdojnë të mbesin në fuqi, megjithëse kufizimet në numrin e mysafirëve të

lejuar në dasma do të hiqen.

"Nëse, pas dy javësh, kemi arritur në përfundimin se rreziku është zvogëluar, atëherë ekziston mundësia që të marrim vendim për një hapje të plotë", ka deklaruar Johnsoni.



Daka: Shkarkimi im është jokushtetues, do t'i ndjek rrugët ligjore

Ish-kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka mbajtur të martën konferencë të jashtëzakonshme për media, në të cilën ka thënë se shkarkimi i saj ishte jokushtetues. Ajo ka paralajmëruar se do t'i ndjekë rrugët ligjore për ta mbrojtur të drejtën e saj

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ish-kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë se vendimi i presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për shkarkimin e saj nga kjo pozitë, është në kundërshtim me Kushtetutën dhe i pambështetur në ligj. Ajo ka thënë se do t'i ndjekë rrugët ligjore për ta mbrojtur të drejtën e saj. "Të akuzohem për mospunë dhe për vendimet kolegjiale të cilat janë marrë nga të gjithë anëtarët e KQZ-së dhe të ndëshkohem vetëm pse kam aplikuar Kushtetutën dhe ligjin është absurditet i llojit të vet dhe, sipas të gjitha gjasave, vendim i porositur", ka thënë Daka të martën në një konferencë për media.

Daka pretendon se vendimi ka qenë i përgatitur më herët dhe përmes tij presidentja e "ka përmbushur kërcënimin dhe premtimin e dhënë gjatë fushatës së fundit zgjedhore për shkarkimin tim". "Publikimit të këtij vendimi i ka paraprirë edhe një takim në të cilin isha e ftuar nga presidentja e Kosovës. Në këtë takim, ajo ka kërkuar që unë ta ofroj dorëheqjen në mënyrë të vullnetshme dhe në këmbim do të pranoja falënderime publike për punën e deritanishme si kryetare e KQZ-së, si dhe më premtoi vazhdim të bashkëpunimit në të ardhmen", ka thënë Daka duke shtuar se "kjo gjuhë dhe sjellje është e papranueshme". Ajo ka thënë se vendimi për shkarkim është i paligjshëm, qesharak dhe i porositur. "Ky është vendim jokushtetues dhe i pambështetur në ligj. Arsyetimi i dhënë në shkarkimin tim jo që është i paligjshëm, por edhe kontradiktor dhe qesharak. Ky është vendim i porositur", ka

thënë Daka.

Më 14 qershor presidentja Osmani ka shkarkuar Valdete Dakën nga pozita e kryesueses së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në këtë pozitë ka emëruar Kreshnik Radoniqin, i cili është gjyqtar në Departamentin Special të Gjykatës së Apelit.

Në vendimin e saj për shkarkimin e Dakës, presidentja Osmani ka thënë se "kryesuesja e KQZ-së, në shumë raste, nuk ka arritur të jetë forcë e pavarur ndaj polarizimeve politike dhe që vendimmarrja e saj të drejtohet nga interesi i përgjithshëm publik e që, për rrjedhojë, ka cenuar integritetin dhe besimin e qytetarëve ndaj KQZ-së".

Partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kanë kundërshtuar vendimin duke thënë se ai rrezikon edhe pavarësinë e mbarëvajtjen e zgjedhjeve lokale.

Po ndaj këtij shkarkimi ka reaguar edhe shoqëria civile. Njëmbëdhjetë organizata të shoqërisë civile kanë kundërshtuar vendimin e presidentes së vendit, Vjosa Osmani-Sadriu, për shkarkimin e kryetares së KQZ-së, Valdete Daka. "Ky vendim konsiderojmë se është i motivuar politikisht, si rezultat i ndërrimit të pushtetit në Kosovë pas zgjedhjeve të fundit. Bazuar në vendimin për shkarkim, ne vlerësojmë që argumentet e shtruar nga presidentja janë të pabazuara dhe paraqesin keqinterpretim të situatave përkatëse. Mes të tjerash, kryetares së KQZ-së i atribuohen ekskluzivisht të gjitha përgjegjësitë dhe dështimet e supozuara të KQZ-së, përkundër faktit që kryetarja e KQZ-së është vetëm një nga njëmbëdhjetë anëtarët me të



Veprimtari Haki Morina: Kryetari i ri i KQZ-së është djali i UDB-ashit Mustafë Radoniqi

Veprimtari, i burgosuri politik dhe autori i librit "Jetë në rrugëtim", Haki Morina, ka reaguar pas emërimit të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit në postin e kryetarit të KQZ-së. Morina përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se kryetari i ri i

KQZ-së është djali i UDB-ashit Mustafë Radoniqi. Ai thotë se babai i Kreshnik Radoniqit e kishte torturuar në burg. "Doli që parandjenja ime nuk ishte e gabuar. Kryetari i ri është djali i UDB-ashit Mustafë Radoniqi, i cili përmendet edhe në librin tim biografik të botuar para

disa vjetësh. Këtë udbash e mbaj mend më shumë për shkak se ishte i vetmi që djersitej sa herë më torturonte. Ndoshta pse ishte pak i moshuar, por ndoshta edhe pse gjendjen fizike nuk e kishte të nivelit të udbashëve të tjerë", ka shkruar Morina.

drejtë vote. Madje rikujtojmë që puna e KQZ-së është vlerësuar pozitivisht nga raportet vendore dhe ato ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve", thuhet në reagimin e këtyre organizatave.

Edhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka kundërshtuar vendimin e Osmanit për shkarkimin e Valdete Dakës nga pozita e kryesueses së KQZ-së. "Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) përmes këtij reagimi bashkohet me organizatat e tjera të shoqërisë civile për ta kundërshtuar vendimin e djeshëm të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, për shkarkimin e kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka. Arsyet e dhëna për shkarkimin e Dakës nuk qëndrojnë, e për më tepër e mvëshin atë me disa përgjegjësi

që nuk janë të sajat, apo vetëm të sajat. KQZ-ja është organ i pavarur kushtetues dhe kryetarja Daka është vetëm një nga njëmbëdhjetë anëtarët me të drejtë vote. Ndër arsyet e shkarkimit figurojnë edhe shkelja e të dhënave personale, si dhe problemet me listat e votuesve. Asnjëra nga këto të dyja nuk bien nën përgjegjësinë e kryetares së KQZ-së, njëra është në fushëveprimtarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, tjetra është përgjegjësi e Agjencisë për Regjistrim Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Po ashtu, sjellim ndërmend se ky vendim i presidentes Osmani vjen në prag të shpalljes së datës së zgjedhjeve lokale që do të mbahen në tetor të këtij viti dhe, përveç që konsiderohet ndikim në punën e pavarur të KQZ-së, mund edhe të ndikojë në

organizimin dhe mbarëvajtjen e këtyre zgjedhjeve", është thënë në reagimin e RrGK-së.

Albert Krasniqi nga "Demokracia Plus" ka reaguar sërish të martën pas shkarkimit të Valdete Dakës dhe emërimit të kryetarit të ri të KQZ-së nga ana e presidentes Vjosa Osmani. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se në vendimin për shkarkimin e kryesueses së KQZ-së, Osmani ka marrë rolin e katër institucioneve të tjera: Gjykatës Kushtetuese, Kuvendit dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi. "Avokati i Popullit ose 30 deputetë, patjetër duhet të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të presidentes për shkarkimin e kryesueses së KQZ-së", ka thënë Krasniqi.

Zgjedhjet lokale mbahen më 17 tetor

Prishtinë, 15 qershor (ER) - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, pas përfundimit të konsultimit me subjektet politike më 2 qershor 2021 dhe në mbështetje të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në

Republikën e Kosovës, ka caktuar 17 tetorin 2021, datë të mbajtjes së zgjedhjeve lokale. "Me të njëjtin vendim, presidentja Osmani ka udhëzuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që t'i

ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve lokale në përpunim me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi", është thënë në njoftimin e Presidencës.





ËSHTË MBAJTUR TAKIMI I PARË NË BRUKSEL NDËRMJET KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS, ALBIN KURTI DHE PRESIDENTIT TË SERBISË, ALEKSANDËR VUÇIQ

Kosova dhe Serbia nuk pajtohen për agjendën e dialogut

Takimi i parë ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka përfunduar pa ndonjë rezultat të martën në Bruksel. Udhëheqësit e të dy shteteve në këtë takim kanë prezantuar temat e tyre, duke mos u pajtuar për agjendën e dialogut të ardhshëm. Kryeministri Kurti ka thënë se në këtë takim ka prezantuar katër propozime të cilat nuk i janë marrë parasysh, ndërsa presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka thënë se nuk do ta njohë kurrë pavarësinë e Kosovës. Takimi i radhës është paraparë të mbahet më 25 korrik

vazhdim të dialogut. Takimi i radhës pritet të mbahet më 15 korrik.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se në takim ka treguar qëndrimin kritik për procesin dhe marrëveshjet e deritanishme dhe ka shprehur gatishmërinë e tij për dialog konstruktiv për njohje të ndërsjellë. “Nuk u pajtuam për agjendën e dialogut të ardhshëm. Unë bëra katër propozime në këtë takim: 1. Gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor e avancojnë CEFTA-n në SEFTA (South-East European Free Trade Agreement) sipas modelit të EFTA-EEA, pra marrëveshje çfarë Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Islanda kanë me BE-në. 2. Kosova dhe Serbia menjëherë nënshkruajnë një marrëveshje të përbashkët të paqes duke u zotuar se nuk do ta sulmojnë njëra-tjetrën. Kjo është e rëndësishme tani si asnjëherë

më parë, një ditë pas Samitit të NATO-s në Bruksel dhe porosive unanime që u dhanë aty”, ka shkruar Kurti në profilin e vet në “Facebook”, pas takimit, duke përmendur çështjen e njohjes dhe çështjen e të pagjeturve. “3. Pas njohjes së ndërsjellë midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në të dy vendet tona do të kemi reciprocitet bilateral, përfshirë çështjen e pakicave këtu. Pra, serbët në Kosovë mund ta kenë Këshillin e tyre Nacional siç e kanë shqiptarët dhe boshnjakët në Serbi. 4. Për çështjen e të pagjeturve, të të zhdukurve me dhunë, duhet larguar nga pozita që ka dhe duhet marrë në pyetje kreun e delegacionit serb, z. Veljko Odaloviç, i cili në vitet 1997-1999, ishte ‘naçelnik i qarkut të Kosovës’ dhe udhëhiqte Kosovën e okupuar bashkë me Zoran Angjelkoviç”, ka shkruar Kurti.

Ai ka treguar se propozimit të tij

të parë nuk i janë përgjigjur, ndërkaq tri propozimet e tjera janë refuzuar. Edhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka deklaruar se me kryeministrin e Kosovës nuk janë pajtuar për asgjë. Vuçiqi ka treguar se Kurti e ka pyetur se a do ta njohë pavarësinë e Kosovës. “Njeriu erdhi që të mos pajtohej për asgjë. Njeriu erdhi që të thotë ‘erdha të të pyes se kur do ta pranosh pavarësinë e Kosovës’. Përgjigjja ime ishte kurrë. Pastaj ai shpërtheu”, ka theksuar Vuçiqi pas takimit.

Presidenti serb ka fajësuar Kosovën se nuk dëshiron t'i plotësojë marrëveshjet që kanë nënshkruar. “Pra, nuk dëshirojnë fare të bisedojnë për Asociacionin e Kosovës. Së dyti, ata kërkuan me urgjencë dhe menjëherë të dëgjojnë se kur do ta pranojmë Kosovën e pavarur dhe, së treti, ata i quajnë incidente dhe provokime faktin që serbët dëshirojnë të marrin

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk janë pajtuar për asgjë të martën në Bruksel, në kuadër të dialogut për normalizim të

marrëdhënieve të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian.

Në takimin e parë Kurti dhe Vuçiqi nuk janë pajtuar për asnjërin nga temat që janë ngritur për diskutim në këtë takim. Ndonëse kanë shprehur qëndrime të kundërta për temat e diskutimit, ata janë pajtuar për

Osmani ia vazhdon mandatin teknik EULEX-it

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Presidentja Vjosa Osmani, nëpërmjet një letre drejtuar përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell Fontelles, e ka njoftuar atë për vazhdimin e mandatit të EULEX-it edhe për një vit. Në

letrën drejtuar Borellit, presidentja Osmani ka njoftuar se EULEX-i do të jetë me mandat teknik, pa fuqi ekzekutive dhe i bazuar vetëm në monitorim, mentorim dhe këshillëdhënie, bazuar në letërkëmbimin e vitit 2018

dhe kërkesave të paraqitura nga presidentja Osmani në letrën e dërguar më 14 qershor. I njëjti mandat mund të vazhdohet edhe për një vit tjetër, në rast të vlerësimit pozitiv të punës së këtij misioni nga presidentja e Republikës së Kosovës.



pjesë në liturgjitë në kishat e tyre, sepse tokat për ato kisha janë dhënë mbase në kohën e pushtetit të Slllobodan Millosheviqit”, ka thënë Vuçiq.

Lajçaku: Takimi nuk ishte i lehtë

I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak, ka thënë se takimi i së martës në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, nuk ka qenë i lehtë. Megjithatë, ai e ka vlerësuar si të rëndësishme atë që ka ndodhur në takim. Diplomati evropian ka deklaruar se procesi i dialogut do të vazhdojë para fundit të korrikut. “Të dy liderët kanë pasur deklarata të sinqerta rreth asaj se çfarë duan palët nga dialogu. Për Bashkimin Evropian është e rëndësishme që të dy liderët konfirmuan se nuk ka rrugë tjetër përveç normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë”, ka thënë Lajçak pas takimit. Sipas tij, si Kurti ashtu edhe Vuçiqi janë pajtuar për normalizim të marrëdhënieve përmes dialogut. Sipas Lajçakut, blloku evropian, bashkë me popullin e Kosovës dhe atë të Serbisë, kanë pritshmëri të larta nga të dy liderët që ta tejkalojnë trashëgiminë e së kaluarës dhe ta shtyjnë Kosovën dhe Serbinë

drejt të ardhmes evropiane. Ndërsa para takimit trepalësh, shefi i diplomacisë i BE-së, Josep Borrell, ka thënë se është i vetëdijshëm që procesi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk do të jetë i lehtë, mirëpo angazhimi i të dyja palëve është i domosdoshëm për popujt e dy vendeve. Borrelli ka thënë se gëzohet që takimi po zhvillohet në kohën e njëjtë kur Bashkimi Evropian takohet me presidentin amerikan Joe Biden. “Kemi një momentum të ri dhe na duhet ta shfrytëzojmë atë”, ka thënë ai, duke thënë se kjo mundësi vlen për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. “Është një rast në BE për diskutimet në Ballkanin Perëndimor dhe është me rëndësi për rajonin që ta shfrytëzojë këtë rast. Dhe ky është rast për tërë rajonin e jo vetëm për Kosovën dhe Serbinë, sepse këto raporte janë të rëndësishme për tërë rajonin. Për stabilitetin afatgjatë, përparimin ekonomik. Përparimet e tjera pa marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë do të jenë të rrezikuara”, ka thënë Borrell. Borrelli ka pohuar se është e qartë se rezultatet e dialogut Kosovë - Serbi shtrojnë rrugën për të ardhmen evropiane për të dyja palët. “Dialogu ka prodhuar rezultate për qytetarët e tyre. Si shembull, integrimi i policisë dhe sistemit

të drejtësisë në veri të Kosovës në sistemin e Kosovës. Mbledhja e tarifave doganore nga tregtia me Serbinë apo edhe pjesëmarrja si anëtar i plotë në organizata të ndryshme rajonale si dhe iniciativa”, ka thënë Borrell. Shefi i diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, fillimisht ka takuar veçmas përfaqësuesit e Kosovës dhe të Serbisë, më pas është mbajtur takimi trepalësh.

PDK-ja akuzon Kurtin se ka braktisur premtimin për dialogun me Serbinë

Zyrtari i Partisë Demokratike të Kosovës, Betim Gjoshi, ka kritikuar takimin e kryeministrit Albin Kurti me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Bruksel. Gjoshi ka thënë se Kurti nuk e ka mbështetur Vasfije Krasniqit dhe as të Saranda Bogujevcit, por është takuar me Vuçiqin sipas kushteve të tij. “Nuk e kanë krahë as Vasfije Krasniqin dhe as Saranda Bogujevcin, por është ballë për ballë me Aleksandër Vuçiqin dhe sipas kushteve të tij. Ky është Albin Kurti që sot braktisi premtimin që ia kishte dhënë Ferdonije Qerkezit e Nusrete Kumnovës për ta kushtëzuar uljen në tavolinën e dialogut me Serbinë me zbardhjen e fatit të fëmijëve të tyre”, ka shkruar Gjoshi në llogarinë e vet në “Facebook”.



Haradinaj: Dështim i plotë i Kurtit në procesin e dialogut

Për takimin që ka zhvilluar të martën në Bruksel kryeministri Albin Kurti me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka reaguar edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se ky takim ishte dështim i plotë i Kurtit në procesin e dialogut. “Është e habitshme pse njohja e Kosovës nuk është prioritet i tij. Prioritet i parë i tij na qenka shndërrimi i CEFTA-s në SEFTA. Qesharake. Ashtu si edhe prioriteti i dytë, marrëveshja për paqe mes dy

vendeve e, po ashtu, edhe qasja për të pagjeturit. Njohja reciproke është i vetmi rezultat që i duhet Kosovës nga ky dialog. Njohja nënkupton edhe paqen, edhe statusin më të avancuar ekonomik, por edhe hap shtigje për zbulimin e të vërtetës për të pagjeturit. Përndryshe, kjo qasje për të biseduar për tema, pa e njohur shtetet njëra-tjetrën, siç kishte ndodhur më parë në procesin e dialogut, nuk ka rezultate, e në këtë fazë është edhe e rrezikshme për vendin”, ka thënë Haradinaj.

Roli i mediave, i rëndësishëm për parandalimin e aksidenteve rrugore

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka zhvilluar të martën një takim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, me ç'rast është diskutuar mbi bashkërendimin e aktiviteteve në sensibilizimin e opinionit për sigurinë në trafik, dhunën në familje dhe parandalimin e narkotikëve. Mehmeti ka thënë se janë të fokusuar mbi ndikimin e

mediave për parandalimin e aksidenteve në trafik dhe koordinimin e aktiviteteve të tjera ndërmjet mediave dhe Policisë së Kosovës. “Me theks të posaçëm biseduam rreth bashkëpunimit mbi parandalimin e aksidenteve në trafik, punën e përbashkët rreth parandalimit dhe luftimit të krimit, ku mediat kanë një rol shumë të rëndësishëm”, ka thënë pas takimit Mehmeti.



Dymbëdhjetë raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Në Kosovë u raportuan të martën 12 raste të reja me Covid-19. Rastet pozitive rezultuan pas testimit të 2 668 mostrave, ka njoftuar Instituti Kombëtar i

Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK). Sipas njoftimit, në 24-orëshin paraprak nuk u regjistrua asnjë viktimë nga Covid-19, ndërsa u shëruan 119 pacientë. Me këto shifra,

sipas IKShPK-së, numri i përgjithshëm i të infektuarve në Kosovë arrin në 107 595, i viktimave në 2 250 dhe i të shëruarve në 105 107. Raste aktive aktualisht janë 238.



Komuna e Kamenicës pranon një donacion me 500 maska nga UNMIK-u

KAMENICË, 15 QERSHOR (ER) - Komuna e Kamenicës, përkatësisht drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Suna Zajmi-Krasniqi, ka pranuar të martën një

donacion prej dhjetë pakove me nga 500 maska nga UNMIK-u.

Drejtoresha e DShMS-së, Suna Zajmi-Krasniqi, është shprehur mirënjohëse ndaj të gjithë atyre që po

vazhdojnë të kontribuojnë për Komunën e Kamenicës. "I jam pafundësisht mirënjohëse UNMIK-ut për donacionin e dhuruar. Ndonëse rastet me Covid-19 janë duke u zvogëluar, pa

dysim se të gjithë ne duhet të jemi të kujdesshëm, andaj maskat janë një faktor i rëndësishëm për parandalimin e mëtutjeshëm të virusit", ka thënë Zajmi-Krasniqi.



Gjilani shpalosi muralin e paqes i punuar në objektin e zyrës së kryetarit

GJILAN, 15 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me gardën ushtarake të Iowas dhe mysafirë të shumtë nga institucione të ndryshme lokale dhe qendrore, kanë shpalosur të martën muralin e paqes, i cili është punuar nga nxënësit e shkollës së artit dhe mesazhi i tij i qartë është paqe e dhe ndërtimin e saj. "Muralin e paqes që sapo kemi shpalosur ia dedikojmë partneritetit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm që kemi me Sioux Cyti, Iowa dhe Gjilanit, njëkohësisht është rikthim i

muralit të paqes i punuar në vitin 2001. Gjilanit do të vazhdojmë t'i japim pamje të qytetit me kulturë. Ne kemi shpallur për artistët e Gjilanit punimin e pesë skulpturave monumentale, që do të vendosen në qytet, përveç monumentit të mjekut që e kemi përzgjedhur tashmë, e që do të vendoset përballë spitalit. Monumentet e tjera do të rishpallen dhe artistët e Gjilanit do të kenë mundësinë të lënë gjurmë me vepra në qytetin e tyre", ka thënë kryetari Haziri, duke uruar ditët e çlirimit për të gjithë qytetarët.



Komuna e Podujevës me dy nisma për bashkëpunim ndërkombëtar

PODUJEVË, 15 QERSHOR (ER) - Kuvendi i Komunës së Podujevës ka mbajtur të martën mbledhje të jashtëzakonshme, në të cilën ka miratuar dy nisma për inicim të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me komunat, Linz - Austri dhe Kestel - Turqi. "Ditë më parë, me iniciativë të Qendrës Kulturore të Kosovës në Bursa, kemi vizituar komunën Kestel në Bursa të Turqisë. Kemi vizituar shumë institucione, objekte të kulturës, biznese dhe plantacione bujqësore, ku kemi vërejtur shumë të përbashkëta dhe mundësi bashkëpunimi me këtë komunë. Por kryesorja janë shqiptarët atje, njerëz të shquar, sidomos në fushën e biznesit të cilët janë garantues të suksesit në këtë bashkëpunim", ka thënë



kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi. Ai ka thënë se në fokus do të jetë

edhe bashkëpunimi në arsim për të siguruar shkëmbime të përvojave, duke dërguar nxënës

dhe mësimdhënës nga Podujeva për t'u trajnuar sidomos në fushën IT-së.

Bulliqi, gjithashtu, ka prezantuar edhe nismën për vendosjen e raporteve të bashkëpunimit edhe me qytetin e Linzit të Austrisë, për të cilin ka thënë se është qytet industrial, ndërsa bashkëpunimi është i iniciuar nga miq, shqiptarë që jetojnë dhe veprojnë në këtë qytet. "Kontaktet e para për bashkëpunim me qytetin e Linzit janë vendosur nga miq, shqiptarë që jetojnë në këtë qytet, pastaj me kryetarin kemi zhvilluar disa komunikime virtuale, kemi ftesë që së shpejti të shkojmë për vizitë dhe t'i kthjellojmë mundësitë e bashkëpunimit", ka thënë Bulliqi, duke shtuar se, krahasuar me Podujevën, ky është qytet i madh dhe fokusi do të jetë bashkëpunimi për zhvillim ekonomik.

Nis dezinfektimi hapësinor në kryeqytet

Prishtinë, 15 qershor (ER) - Dezinfektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës ka filluar, duke nisur në lagjen Pejton, Aktash, Parku i qytetit, qendra e qytetit, Vellushë, Tophane, lagjja e Muhaxherëve dhe te

Vneshtat. Për gjashtë mbrëmje me radhë pritet të dezinfektohen lagjet e ndryshme të zonës urbane dhe rurale të Prishtinës. Komuna e Prishtinës është duke monitoruar tërë

procesin dhe ka falënderuar qytetarët për bashkëpunimin e deritanishëm. "Sot vazhdojë nga ora 19:30 në lagjet Ulpianë, Dardani, Arbëri, Shkabaj, zona

Industriale dhe Kazerma 'Adem Jashari'. Plani për dezinfektim, për ditët në vijim, është publikuar tashmë në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Vitia: Objektivi ynë mbetet vaksinimi deri në 60 për qind i qytetarëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, në një konferencë për media mbajtur të martën, ka thënë se ministria që drejton, në bashkëpunim me institucionet shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe partnerët e tjerë, i ka bërë përgatitjet për fillimin dhe realizimin e planit të veprimit për vaksinimin e qytetarëve në masë me vaksinën kundër Covid-19. “Nga sot po hyjmë në një fazë të re të procesit të vaksinimit kundër Covid-19. Sikurse jemi zotuar para juve, sot, më 15 qershor, po fillon ky proces i vaksinimit. Ky moment shënon një kapërcim në luftën tonë kundër Covidit, sepse vaksinimi në masë është proces jetik për sigurimin e imunitetit kolektiv të popullatës sonë dhe për krijimin e kushteve për kthimin në një realitet të ri”, ka thënë Vitia. Ai ka theksuar se vaksinimi masiv është proces që kërkon përgatitje,



mobilizim dhe, mbi të, gjitha profesionalizim dhe vullnet për të kontribuar. “Kjo do të jetë një ndërmarrje institucionale dhe organizative e paprovuar ndonjëherë në vendin tonë. Ne kemi bërë përgatitjen për zbatimin e saj dhe jemi të gatshëm për ta përmirësuar atë përgjatë rrugës përballë çdo sfide”, është shprehur ai. Ministri Vitia ka thënë se me

qëllim të mbarëvajtjes së procesit, Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me komunat, ka krijuar hapësira të reja për vaksinim; ka shtuar kapacitetet njerëzore duke organizuar 279 ekipe të vaksinimit në nivel vendi (nga 89 sa ishin deri tani); ka ngritur infrastrukturën e nevojshme. “Ka siguruar vaksina të mjaftueshme; ka zhvilluar

modulin e vaksinimit; dhe riorganizuar edhe aspektet logjistike, me qëllim që vaksinimi në masë të fillojë dhe qytetarët të vaksinohen sipas kategorive të përcaktuara në planin shtetëror të vaksinimit kundër Covid-19 dhe kategorive të përcaktuara në tri fazat e këtij plani. “Falënderojmë edhe inspektorët, forcat tona policore dhe ushtarët tanë të

cilët po ndihmojnë vazhdimisht në këtë proces. Ky për momentin është procesi më i rëndësishëm në vendin tonë, marrë parasysh se shumë sfera të jetës sonë të përditshme varen nga suksesi i këtij procesi. Sot kemi kaluar shifrën prej 100 000 të vaksinuarve. Objektivi ynë mbetet vaksinimi i deri në 60 për qind të qytetarëve. Me pjesëmarrjen, bashkëpunimin dhe punën e të gjithëve, ne do ta arrijmë këtë”, është shprehur ministri Vitia, duke theksuar se aktualisht janë duke u vaksinuar kategoria e personave mbi 65 vjeç dhe personat me sëmundje kronike, pa dallim moshe. “Me zgjerimin e procesit do të vaksinohen edhe mësimdhënësit, forcat e sigurisë të ndërlidhura drejtpërdrejt me menaxhimin e Covid-19. Për ta vazhduar pastaj fazën e tretë me grupmoshat nën 65 vjeç, punëtorët e sektorit publik dhe kategoritë e tjera të popullatës. Me një fjalë, të gjithë ata që duhet vaksinuar dhe imunizuar”, ka deklaruar Vitia.

Në gjashtëmuajorin e dytë të 2020-s janë sekuestruar 649 armë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ministria e Punëve të Brendshme ka mbajtur takimin e pestë për udhërrëfyesin rreth armëve të vogla dhe të lehta. Takimin e hapi ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçlaku, ku theksoi lart angazhimin dhe mbështetjen e aktorëve lokalë dhe rajonalë të përfshirë në këtë proces, si dhe kontributin e tyre për sigurinë e qytetarëve të Kosovës, rajonit dhe më gjerë. Gjatë këtij takimi ministri Sveçla ka thënë se Kosova, sikurse edhe vendet e tjera të rajonit, vazhdon të përballet me problematikën që sjell përdorimi i paligjshëm i armëve dhe trafikimi i tyre, duke veçuar se vetëm për periudhën e raportimit, që përfshinë gjashtëmuajorin e



dytë të vitit 2020, janë sekuestruar 649 armë dhe 27 030 copë municione. “Lufta kundër trafikimit të armëve të

paligjshme dhe bashkëpunimi dhe koordinimi i gjithë aktorëve në këtë fushë, është parakusht

dhe për të arritur deri tek objektivi ynë i përbashkët, e që është siguria për të gjithë qytetarët tanë. Një Kosovë e sigurt

nënkupton një Evropë më të sigurt, prandaj rruga dhe angazhimi ynë është dhe duhet të jetë i përbashkët”, ka thënë Sveçla.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte që të rishikohet progresi i zbatimit të udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme të armëmbajtjes pa leje si dhe trafikimi i armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre në nivel lokal.

Udhërrëfyesi u miratua gjatë takimit të ministrave të Brendshëm dhe të Sigurisë së Samitit të Ballkanit Perëndimor të organizuar në Londër më 10 korrik 2018 si angazhimi më i madhi i kontrollit të armëve në rajon, duke mbuluar të gjitha aspektet kryesore nga sigurimi i rezervave të armëve të zjarrit dhe municioneve deri tek integrimi perspektivës gjinisë në kontrollin e AVL-ve.

MAShTI ndryshon datat për përfundimin e vitit shkollor

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MAShTI) ka vendosur që t'i ndryshojë datat për përfundimin e vitit shkollor. Në vendimin të

cilin MAShTI e ka marrë të martën, thuhet se parashkollorët, klasat nga e para e deri në të tetën, do të përfundojnë mësimin më 2 korrik, kurse klasat 9, 10 dhe 11 do ta përfundojnë mësimin më 21 qershor.

Ditë më parë ministrja Arbërie Nagavci në një konferencë për media kishte bërë me dije se viti shkollor do të përfundojë më 2 korrik, kurse testi i maturës do të mbahej më 26 qershor.



Varri i Mehmetriza Murtezanit në gjendje të mjeruar



Lulëzim ETEMAJ

Mehmetriza Murtezani-Gega lindi në Tetovë më 23 nëntor 1921. Vite me radhë punoi mësues në shkollën e Nerashtit dhe Grupçinit. Me angazhimin e tij dhe të kolegëve kishte shtuar numrin e nxënësve në Nerashtë prej 60 në 240 sish, përfshirë këtu edhe numrin e vajzave. Ky angazhim binte ndesh me pushtetin, i cili paralelisht angazhohej për hapjen e shkollave turke në vitet 1950-1952. Si rezultat i këtij kundërshtimi shumë shpejt e largojnë nga puna. Për herë të parë arrestohet në mars të vitit 1948 nga organet


maqedonase. Lirohet pas një muaji qëndrimi në burg. Si rezultat i angazhimit të tij atdhetar jo vetëm në Tetovë, Gostivar, Strugë, Shkup, por edhe në Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan, Mehmet Gega arrestohet nga UDB-a maqedonase më 21 maj të vitit 1955 në qytetin e Shkupit. U dënua me dhjetë vjet burgim të rëndë dhe u lirua pas shtatë vjetësh, në mars të vitit 1962. Vetëm gjashtë vjet më vonë ai arrestohet sërish më 24 dhjetor 1968, një ditë pas demonstratave në Tetovë, të cilat i kishte organizuar dhe drejtuar së bashku me bashkëpunuesit të tjerë. Sipas aktakuzës, "ai ka dashur që me dhunë ta bëjë shkëputjen e viseve perëndimore të Maqedonisë dhe bashkimin e tyre me Kosovën dhe Shqipërinë". Në vitin 1969 dënohet me shtatë vjet burg, gjashtë nga të cilat i vuan të plota.



E '81-ta ishte vazhdimësi e '68-s. Mehmet Murtezani-Gega ishte një nga frymëzuesit dhe prijësit kryesorë të brezit '81, i njohur si Brezi i Pranverës Shqiptare. Shënimi i 40-vjetorit të saj nëpër qytete të tjera, duke e lënë në harresë atë, është më tepër sesa një skandal! Në vitin 1990-1991 Mehmetriza Murtezani-Gega shquhet për përkrahjen e fuqishme që ia jep pajtimit të gjaqeve në Kosovë, të filluar më 2 shkurt 1990 nga rinia studentore e Pejës, dhe të rinjve bartës të këtij pajtimi nga Tetova dhe Gostivari. Mehmetriza Murtezani-Gega, i njohur me të drejtë edhe si

"Demaçi i Tetovës", ishte frymëzuesi dhe prijësi kombëtar i brezave të tërë jo vetëm të Tetovës. Para disa ditësh, së bashku me disa miq nga Tetova dhe Prishtina, shkuam për ta vizituar varrin e tij. Vetëm pasi ia fshimë pluhurin nga pllaka e mermerit mundëm ta identifikojmë. Nga dëmtimi i punimit dhe shkronjave, nuk vërehej harta e as nuk lexoheshin mbishkrimi apo emrat e qyteteve të Shqipërisë së bashkuar. Shtyllat e varrit i gjetëm në një gjendje të mjerueshme. Të thyera, të shpërndara e të mbuluara nga bari!

Varri i Mehmet Gegës nuk është një varr i rëndomtë, ani pse ndodhet në mesin e varrezave të rëndomta të Tetovës. Mirëmbajtja e këtij varri nuk është detyrë e vajzës, por as e nipave dhe mbesave të tij. Nuk është detyrë as e nxënësve të shkollës së tij kombëtare apo qytetarëve të tjerë. Mirëmbajtja është detyrë e komunës së Tetovës. Ajo duhet të kujdeset për rregullimin dhe mirëmbajtjen e tij, duke i ngritur një rrethojë dhe vendosur një flamur shqiptar te koka, ngritur në një shtizë të lartë. Ai meriton më shumë se vetëm një varr të harruar e të dëmtuar!



Gjendja e sigurisë në shkollat e Prizrenit vlerësohet e mirë

PRIZREN, 15 QERSHOR (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur të martën mbledhjen e parë për vitin 2021. Mbledhja u mbajt nën kryesimin e kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ku fillimisht u miratua rendi i ditës dhe plani i punës së KKS-së për vitin 2021. Mbledhja ka vazhduar me raportin e Policisë së Kosovës për periudhën janar-prill 2021, ku u njoftua se situata e përgjithshme në vend është e qetë. Me këtë rast u prezantuan raportet me të dhënat statistikore për raste të ndryshme nga Stacioni Policor në Jug, Stacioni Policor në Veri,

nga vija e gjelbër dhe nga pika e kalimit kufitar në Vermicë. Më pas u vazhduar me temën "Vlerësimi i sigurisë në shkollat", ku zyrtari nga Drejtoria Komonale e Arsimit ka njoftuar se gjendja e sigurisë nëpër shkollat është e mirë në përgjithësi falë bashkëpunimit me policinë. Gjatë kësaj pike të rendit të ditës, kryetari Haskuka ka njoftuar se vitin e kaluar Komuna e Prizrenit ka realizuar pilot-projektin "Monitorimi dhe vlerësimi i nevojave të shkollës", ku janë përfshirë nxënësit, mësuesit, drejtorët e shkollave dhe prindërit e pesë shkollave të ndryshme fillore

dhe të mesme të ulëta. Sipas rezultateve të këtij hulumtimi, Haskuka ka bërë me dije se nxënësit janë shprehur se ndihen të sigurt dhe të mbrojtur në ambientet shkollorë dhe se 71 për qind e nxënësve janë të kënaqur me qasjen e shkollës (drejtorit, mësuesit dhe stafit të shkollës) ndaj tyre. Haskuka ka theksuar se problemet që paraqiten zakonisht po ndodhin në ambientet jashtë shkollës, përkatësisht gjatë rrugës nga shkolla për në shtëpi, me ç'rast ka kërkuar rritjen e patrullimeve policore gjatë orareve të daljes nga shkolla. Në vazhdim, drejtori i Drejtorisë



për Emergjencë dhe Siguri, Faruk Dakaj, ka njoftuar se tanimë Shërbimit Zjarrfikës të Komunës së Prizrenit i janë shtuar edhe 31 zjarrfikës të rinj, duke rritur numrin e

punëtorëve të këtij shërbimi në 55. Ai ka bërë me dije se së shpejti do të hapen edhe tre nënstacione të reja, përkatësisht në Zhur, Zhupë dhe në Reçanë.

Hajdari: Jemi duke punuar për formimin e Gjykatës Komerciale

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Në Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti ka raportuar ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, e cila para anëtarëve të këtij komisioni ka raportuar për planin e kësaj ministrie për vitin 2021.

Ministrja Hajdari ka thënë se, sipas planit të ministrisë, ka për qëllim arritjen e disa objektivave: përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes, nxitjen e investimeve të huaja, përmirësimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe zhvillimin e politikave tregtare. Ajo ka thënë se në ministrinë që drejton ka gjetur shumë punë të pakryera.

Hajdari ka treguar se janë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë për themelimin e Gjykatës Komerciale. "Ne kemi



trashëguar një sistem të shturur në ministri dhe politikat për shumë ligje nuk ekzistojnë", është shprehur ajo. Ajo ka thënë se këtë vit ka në plan edhe zbatimin e shumë masave të MSA-së. "Ligji për investimet strategjike është devijuar në vitin 2018 dhe ne jemi në një situatë të

palakmueshme si qeveri duke trashëguar disa projekte. Është synim i ministrisë që të ofrojë bashkëpunim me sektorin privat, derisa ne kemi një rini me shpirt ndërmarrësie. Do të ishte mirë që lënda e ndërmarrësisë të jetë në shkollat fillore. Po ashtu, ne kemi një plan për zbatimin e

shumë masave të MSA-së për këtë vit", ka thënë Hajdari, duke theksuar se ka trashëguar një udhëzim administrativ të nënshkruar jashtëligjshëm nga ish-ministri Vesel Krasniqi. "Ne kemi trashëguar një udhëzim administrativ jashtëligjshëm nga ministri Veseli që ka shkaktuar probleme, i cili

parasheh maskimin dhe monitorimin e karburanteve të naftës. Nuk kemi mundur që këtë udhëzim ta shfuqizojmë komplet", ka thënë ministrja Hajdari.

Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Ferat Shala, ka thënë se këtë ministri e ka udhëhequr edhe Mimoza Kusari-Lila. Shala ka shtruar disa pyetje për ministrin Hajdari: "Nuk morëm përgjigje se çfarë do të ndodhë me investitorët që janë parakualifikuar? Cilat janë politikat që bien ndesh me politikat nacionale dhe këto bien ndesh me kolegen tuaj karshi që e keni (Mimoza Kusari-Lila), sepse edhe ajo e ka udhëhequr këtë dikaster. Çka do të ndodhë me bizneset që janë parakualifikuar dhe po presin përgjigje? Gjithashtu, në programin legjislativ nuk e keni ligjin për mbrojtjen e konsumatorit. Si do ta realizoni këtë?"

Fillon ekzekutimi i pagesave të subvencioneve në bujqësi

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ministra e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka njoftuar të martën se ka filluar ekzekutimin e pagesave të subvencioneve (kësti i dytë).

Pas marrjes së opinionit ligjor nga Zyra e Kryeministrit, Ministrisë së Financave, të Punës dhe Transfereve dhe themelimit të Task Forcës nga ministri Faton Peci, ka filluar procesi i pagesës së subvencioneve të dyta. "Për fermerët dhe opinionin rikujtojmë se procesi i shpërndarjes së subvencioneve në Ministrinë e Bujqësisë ka qenë një proces shumë delikat sepse përfituesit në të kaluarën janë njoftuar pa mbulesë financiare. Njëkohësisht, mënyra e shpërndarjes së subvencioneve në të kaluarën është aktualisht objekt i

hetimeve nga organet e rendit. Si rrjedhojë e kësaj, çdo veprim i ndërmarrë ka paraqitur domosdoshmërinë e marrjes së opinionëve ligjorë deri në sigurimin e mjeteve si dhe bashkëpunimin e duhur me organet e rendit si garanci e mosdëmtimit të procesit", thuhet në njoftimin e kësaj ministrie.

Task Forca e themeluar nga ministri Faton Peci ka për mandat shqyrtimin dhe verifikimin e secilës lëndë e cila gjendet në procedurë të realizimit të pagesave në pajtim me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me Udhëzim Administrativ.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, për të parë nga afër ecurinë e veprimtarive bujqësore dhe blegtorale, ka vizituar kooperativën bujqësore "Krusha" në Krushë të Madhe, si dhe blegtorët e vreshtarët e



Komunës së Prizrenit dhe Rahovecit.

Ministri Peci gjatë vizitës në

teren vështroi se si blegtorë, fermerë e vreshtarë të shumtë janë liderë të cilësisë si në

tregun vendor, po ashtu edhe në tregje ndërkombëtare edhe përkundër mungesës së përkrahjes institucionale dhe devijimeve të shumta me grante dhe subvencione në këto fusha. Ai, po ashtu, u njoftua nga afër me të gjitha sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen prodhuesit dhe përpunuesit e kësaj ane, të cilët do ta kenë mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë gjatë këtij mandati, me qëllim që përmes përkrahjes financiare, veprimtaritë e tyre bujqësore e blegtorale të zhvillohen e avancohen çdo ditë e më shumë.


Ministri Peci, gjithashtu, i njoftoi se do të angazhohet maksimalisht për hartimin e duhur të politikave sektoriale të cilat lehtësojnë aktivitetet bujqësore dhe stimulojnë gjetjen e tregjeve të reja drejt avancimit ekonomik të sektorit të bujqësisë.

Për herë të parë në Shqipëri kartëmonedha 10 mijë lekëshe del në treg nga korriku

TIRANË, 15 QERSHOR - Nga muaji korrik për herë të parë në treg do të hidhet në qarkullim kartëmonedha 10 mijë lekëshe, njëherësh do të prodhohet edhe një seri e re me prerje 1000 lekë. Kartëmonedhat u prezantuan këtë të martë në Bankën e Shqipërisë nga

gubernatori Gent Sejko. Në ceremoninë e prezantimit të kartëmonedhave të reja, ai ka thënë se prerja e re 10 mijë lekëshe është nevojë e lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit dhe plotëson kërkesat e tregut për të pasur një prerje të tillë.

Kartëmonedha 10 000 lekë mbart si tematikë simbolet e flamurit kombëtar dhe himnit, të shoqëruar me portretin e poetit tonë të Rilindjes Kombëtare, Asdreni, dhe si të gjitha prerjet e serisë së re, edhe kjo kartëmonedhë përmban elemente sigurie të avancuara.





Shkodran Dakaj dhe 'Armagedoni' i dhurojnë libra shkollës 'Esad Mekuli'

Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Esad Mekuli" në fshatin Caravik të Klinës sot është pasuruar me 177 ekzemplarë të librave të gjashtëdhjetë autorëve shqiptarë dhe të huaj, botime të shtëpisë botuese "Armagedoni". Këtë donacion të librave për këtë shkollë e kanë dhuruar ndërmarrësi Shkodran Dakaj nga fshati Caravik dhe drejtori i shtëpisë botuese "Armagedoni", Berat Dakaj.

Vlera e librave të dhuruar është 1 001.03 (një mijë e një euro e zero tre centë).

Me rastin e dorëzimit të këtyre librave, shkolla "Esad Mekuli" donatorëve u ka dhënë nga një mirënjohje për pasurimin e bibliotekës së shkollës me libra. Drejtoresha e kësaj shkolle, Arbenitë Bashota, e cila së bashku me mësuesit Gani Jakupi, Fazli Ferati dhe Enver Bashota kanë bërë pranimin e

tyre, tha se këta ekzemplarë të librave kanë qenë shumë të nevojshëm për shkollën tonë, pasi që biblioteka e shkollës ka tituj të paktë të librave për lexim, kurse kërkesat e nxënësve janë të shumta.

Ndërkaq donatorët, Agim (babai i Shkodranit) dhe Berat Dakaj, thanë se edhe në të ardhmen do ta pasurojnë këtë shkollë me tituj të ri të librave dhe me inventar.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



KE i FFK-së mbajti mbledhjen e radhës, nuk shkarkohet Eroll Salihu

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Komiteti Ekzekutiv (KE) i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) mbajti sot mbledhjen e radhës nën drejtimin e kryetarit Agim Ademi, ku diskutoi për shumë çështje në futbollin e Kosovës. Pavarësisht se ishte paralajmëruar se do të shkarkohet sekretari i

përgjithshëm, Eroll Salihu, një gjë e tillë nuk ndodhi. KE shqyrtoi Projekt Strategjinë Zhvillimore të FFK-së, ku do të përfshihen objektivat afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të futbollit të Kosovës në të gjitha fushat. KE diskutoi edhe për përkrahje të klubeve që kanë kaluar në rang më të

lartë të garave, duke konstatuar se jo të gjitha kanë kushtet e nevojshme, ndaj FFK-ja do t'u dalë në ndihmë që të jenë të përgatitura në përputhje me rangun e garave. KE analizoi edhe ndeshjet e Përfaqësueses A që pati gjatë kësaj periudhe dhe konstatoi se ishin ndeshje të mirëseardhura për

konsolidimin e Përfaqësueses para ndeshjeve kualifikuese për Botërorin 2022. Gjithashtu, u diskutua edhe për përgatitjet që duhet të ndërmarrin të gjitha organet e FFK-së për edicionin e ri të garave 2021/2022, si dhe shqyrtoi ankesat dhe parashtrësat drejtuar këtij organi.



Prishtina, Llapi dhe Drita mësojnë kundërshtarët në garat ndërkombëtare

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Në Nion të Zvicrës të martën është hedhur shorti i raundit të parë të UEFA Champions League. Fituesi i turnirit preliminar në Shqipëri në raundin e parë do të ndeshet me kampionët dhe skuadrën më të madhe hungareze, Ferencvarosi Budapest. Në raundin e parë zhvillohen dy ndeshje, vajte-ardhje dhe zhvillohen më 6/7 korrik e para dhe 13/14 korrik e dyta. Ferencvarosh është vendase në ndeshjen e parë. Edhe fituesi i Kupës, Llapi dhe nënkampionia, Drita, i kanë mësuar kundërshtarët e tyre në rrethin e parë kualifikues në Europa Conference League. Shorti i hedhur të martën në Nyon i ka vënë klubet e Kosovës përballë klubeve nga shtetet fqinje, me Llapi që do të ballafaqohet me Shkupin e Maqedonisë së Veriut dhe Dritën që do të ketë punë me Deçin e Malit të Zi. Rrethi i parë kualifikues i ka dy ndeshje, vajte-ardhje, dhe zhvillohet më 8 dhe 15 korrik. Llapi do të



marrë pjesë në kualifikime për një garë evropiane për herë të parë në historinë e klubit dhe këtë e arriti falë triumfit në Kupën e Kosovës. Ndërkohë, Drita merr pjesë për herë të parë në kualifikimet e kësaj gare të re, si nënkampione e Superligës. Europa Conference League do të jetë gara e tretë e UEFA-s për klube dhe do të zhvillohet në të njëjtën kohë me Ligën e Kampioneve dhe Ligën e

Evropës. Ajo do të jetë një garë evropiane e kategorisë të tretë, pas garës më prestigjioze, Ligës së Kampioneve dhe garës dytësore, Ligës së Evropës. Qëllimi për jetësimin e kësaj lige ka qenë për t'u dhënë më shumë klubeve mundësi në futbollin evropian, posaçërisht atyre nga vendet që e kanë shumë të vështirë të kualifikohen në garat e UEFA-s, siç është Kosova, për shembull.

Clippersat barazojnë serinë finale ndaj Utahs

LOS ANXHELOS, 15 QERSHOR - Los Angeles Clippers fiton ndeshjen e katërt ndaj Utah Jazzit dhe barazon 2-2 serinë e gjysmëfinaleve të Konferencës së Perëndimit mes tyre. Në "Staples Center" skuadra kaliforniane e mbështetur fort edhe nga publiku vendas kishte një marsh më shumë se ekipi më i mirë i sezonit të rregullt në NBA duke triumfuar me rezultatin e thellë 118-104. Donovan Mitchell koleksionoi në total 37 pikë, 5 rebounde dhe pesë asistime, por paraqitja e shkëlqyer e yllit të Utah nuk ishte e mjaftueshme për skuadrën nga "Salt Lake City". Te

Clippersi spikatën, si gjithmonë, dy liderët e skuadrës kaliforniane, Paul George dhe Kawhi Leonard, që realizuan nga 31 pikë secili, ndërsa kontribuuan edhe 16 rebounde e 7 asistime të dy së bashku. Tashmë përballja mes tyre do të zhvendoset në "Salt Lake City" me ndeshjen e pestë të serisë që do të luhet në parketin e Utah. Barazoi në 2-2 serinë ndaj Philadelphia 76ers edhe Atlanta Hawksi që mposhti me rezultatin e ngushtë 103-100 në përballjen e 4-të, skuadrën më të mirë të sezonit të rregullt në Konferencën e Lindjes. Trae Young ishte ai që udhëhoqi



skuadrën nga Georgia falë 25 pikëve, 4 rikuperimeve poshtë tabelës dhe 18 pasimeve decizive, ndërkohë që edhe serbi Bogdanović spikati me 22 pikë. Edhe pse e pa veten në disavantazhin e 13 pikëve në fund të periodës së parë, Atlanta arriti t'i përmbyste shifrat duke marrë një fitore shumë të rëndësishme.

Schmeicheli thotë se është krenar që ka një kapiten si Kjaeri

Portieri i Danimarkës, Kasper Schmeichel, është krenar që ka Simon Kjaer kapiten në ekipin kombëtar, pas veprimit që bëri në rastin e Christian Eriksenit. Mesfushori i Interit pësoi një sulm në zemër dhe iu dha CPR urgjente në fushë.

Lojtarët e Danimarkës ishin në gjendje të flisnin me Eriksenin përmes telefonit të nesërmen. "Ishte e bukur ta shihje atë të buzëqeshur dhe të qeshtë dhe të ishte vetvetja dhe thjeshtë të ndiejë se është atje. Ishte një përvojë e shkëlqyer dhe diçka që më ka ndihmuar shumë", ka thënë Schmeichel për DR. "Unë e njoh

gruan e tij dhe fëmijët e tij, është një situatë absurde. Gjëja më e rëndësishme është që ai të ndihet mirë tani. Ai ka përjetuar diçka që nuk mund ta dimë". Mbrojtësi i Milanit, Simon Kjaer, i dha ndihmën e parë shokut të tij të skuadrës, duke e parandaluar atë që ta gëlltiste

gjuhën dhe ta vendoste në pozicionin e rimëkëmbjes para se të fillonte CPR. "Unë jam tepër krenar që kam Kjaer si kapiten. Nuk u habita që ai bëri atë që bëri. Ai ka një njerëzim të jashtëzakonshëm. Gjithashtu, Simon dhe Christian kanë kaluar shumë kohë së bashku në Milano", ka deklaruar portieri.

SHKURT

Drita konfirmon largimin e Brdarovskit

Ish-skuadra kampione e Kosovës në futboll, Drita, ka njoftuar të martën se mbrojtësi Vladica Brdarovski do të largohet nga klubi pasi i ka përfunduar kontrata. Siç dihet, skuadra gjilanase për këtë pozitë e ka transferuar mbrojtësin Përparim Islami i cili në dy edicionet e fundit ishte pjesë e klubit të Feronikelit. "Mbrojtësi i djathtë, Vladica Brdarovski, ka përfunduar kontratën me klubin dhe nuk do të jetë më pjesë e klubit. Brda erdhi një vit më parë nga ekipi i Vardarit të Maqedonisë së Veriut. Lëndimet e mbajtën jashtë fushës për më shumë se dy muaj ku arriti që të paraqitet vetëm në 17 ndeshje kampionale. Klubi ynë e falënderon Brdarovskin për kontributin e dhënë për klubin dhe profesionalizmin e treguar dhe i dëshiron suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Dritës.

De Bruyne luan ndaj Danimarkës

Mesfushori i Belgjikës, Kevin De Bruyne, është kthyer në stërvitje me pjesën tjetër të skuadrës, duke rritur shpresat se ai do të jetë në dispozicion për ndeshjen e së enjtes kundër Danimarkës në Kampionatin Evropian. De Bruyne nuk ishte në fitoren 3-0 të Belgjikës ndaj Rusisë në Shën Petersburg. 29-vjeçari pësoi frakturë në fytyrë në finalen e Ligës së Kampioneve pas një përplasje me mbrojtësin e Chelseas, Antonio Rudiger, muajin e kaluar. De Bruyne iu desh ta linte fushën e lojës në minutën e 60 të ndeshjes, të cilën Chelsea e fitoi 1-0. Federata belge e futbollit zbuloi në një deklaratë se De Bruyne është stërvitur me pjesën tjetër të grupit që nga dita e hënë.

Nëse Donnarumma transferohet në PSG, Navasi duhet të largohet

Keylor Navas përfundon në merkato. Portieri i Paris Saint Germanit sapo ka rinovuar kontratën deri më 2024 me francezët, por afrimi i mundshëm në ekipin e Gianluigi Donnarumma, i cili do të largohet nga Milani, i ndryshon shumë gjërat. Sipas mediave franceze, Navas e ka vuajtur shumë qëndrimin në stol te Real Madridi, kur te madriletit u transferua Courtois, i cili i mori vendin e titullarit dhe një situatë të tillë 34-vjeçari nuk dëshiron ta përfytyrojë sërish. Në të tilla kushte lojtari nga Kosta Rika ka nisur të kërkojë një sistemim të ri dhe klubet që kanë shfaqur interes për të nuk mungojnë me Juventusin, Milanin e Manchester Unitedin, që janë vënë në ndjekje të tij. Për ta lënë të lirë futbollistin, parisienët kërkojnë 12 milionë euro.

Vidali mendon të largohet nga Interi

Protagonist i një penalltie të gabuar me Kilin e tij në barazimin 1-1 kundër Argentinës në ndeshjen e parë të Kupës së Amerikës, Arturo Vidal vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes për sa i takon merkatos. Në fund të ndeshjes kundër bardhekaltërve, mesfushori i Interit ka folur për të ardhmen e tij. Luftëtari nuk e ka fshehur kurrë dëshirën për të luajtur një ditë për Club America, skuadër meksikane. Duke folur për TDUN, Vidal ka thënë: "Kam thënë gjithmonë se më pëlqen Meksika, më pëlqen Club America. Shpresoj që një ditë të më jepet kjo mundësi. Por them se duhet të ketë një interes nga të dyja palët dhe se tani jam tek Interi".



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Apliko saktë Normën e TVSH-së!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat, të cilët janë Deklarues të TVSH-së, se në bazë të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, janë të detyruar të aplikojnë saktë Normën e TVSH-së në furnizimet e tyre, si: furnizim të mallrave apo furnizim të shërbimeve.

Deklaruesit e TVSH-së, duhet të deklarojnë saktë furnizimet e tyre duke aplikuar Normën e TVSH-së konform Ligjit të TVSH-së, si:

- Shitjet e liruar pa të drejtë kreditimi;
- Shitjet e liruar me të drejtë kreditimi;
- Eksportet;
- Shitjet e tatueshme me normën 18%;
- Shitjet e tatueshme me normën 8%.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen te bizneset - Deklarues të TVSH-së, me qëllim të identifikimit të atyre bizneseve, të cilat nuk janë duke aplikuar saktë Normën e TVSH-së.

Disa nga këta tatimpagues, nuk janë duke zbatuar këtë obligim, prandaj ATK, u bënë thirrje që me rastin e furnizimit të mallrave/shërbimeve të aplikojnë saktë Normën e TVSH-së, në mënyrë që edhe konsumatorët të paguajnë TVSH-në konform Ligjit të TVSH-së.

ATK, inkurajon të gjithë tatimpaguesit – Deklarues të TVSH-së që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK, do të detyrohet që të ndër marrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimit me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Administrata Tatimore e Kosovës

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Kole Oroshi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Elmond Hoxha shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt " 11 Marsi " Prizren.

► Perparim Shala shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dy Dëshmorët " Pirane.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE

